



Revistë  
elektronike

maj 2017

## Edukim seksual gjithëpërfshirës për një jetë premtuese

### Krijimi i një mjedisi mbështetës për seksualitetin e të rinjve

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH), shoqatë anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Planifikimit Familjar – IPPF, që nga viti 2011 ka zbatuar një program të zgjeruar të edukimit seksual gjithëpërfshirës që ka përfshirë: trajnimin e mësuesve, të nxënësve, prindërve, fushata informimi, aktivitete të kom unikimit si: teatër, video mesazhe dhe avokasi etj.

### Edukimi seksual në Shqipëri

Vitet e fundit Shqipëria ka njohur një zhvillim të jashtëzakonshëm lidhur me hartimin dhe zbatimin e edukimit seksual në shkolla. Edukimi bazohet në udhëzues ndërkombëtarë dhe është një produkt bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunëtorëve të tjerë.



*Të rinjtë nga grupet në nevojë duke diskutuar për seksualitetin dhe të drejtat*

duke patur në fokus të vecantë grupet në nevojë, të rinjtë që jetojnë në fshat, të rinjtë rom dhe të rinjtë që nuk shkojnë në shkollë.

Edukimi seksual është ofruar në qendrat rinore të QSHPZH-së, si edhe në komunitetet ku këto grupe jetojnë, apo mblidhen. Sesionet kanë mbuluar çështje të tilla si HIV/SIDA, kënaqësia seksuale, gjinia dhe të drejtat dhe dhuna. QSHPZH gjithashtu dhe organizata të tjera që mbështesin homoseksualët, lezbiket, biseksualët dhe transgjitorët kanë ofruar sesione specifike mbi të drejtat seksuale të të rinjve, barazinë gjinore, shërbimet miqësore për të rinjtë edhe për këtë grup të rinjsh.

## Kundërshtarët ndaj Edukimit Seksual gjithëpërfshirës



Në vend ka kundërshtarë për edukimin seksual në shkollë. Disa prindër dhe kujdestarë, pjesëtarë të komunitetit dhe mësimdhënës e shohin edukimin seksual si faktor që i shtyn të rinjtë në veprimtari të hershme seksuale. Ata gjithashtu argumentojnë se edukimi seksual mund të jetë i mirë për të rinjtë, por jo për fëmijët në moshë të re. Kurrikula shkollore përfshin të rinjtë e përjashtuar dhe adresimin e nevojave të tyre, por nuk ka strategji për t'i arritur ata.

## Ligjet dhe politikat

Në 2012, Ministria e Shëndetësisë përshtati një akt nënligjor të titulluar “Miratimi i dokumentit të pozicionimit për edukimin seksual gjithëpërfshirës për të rinjtë në Shqipëri”. Ky dokument thekson parimet e edukimit seksual, në të qenit gjithëpërfshirës dhe i bazuar tek të drejtat njerëzore. Dokumenti gjithashtu përcakton përpjekjet shumë-sektoriale dhe qëllimin e edukimit si parandalues të sjelljeve të rrezikshme tek të rinjtë.

Në 2015, programi i edukimit seksual, i titulluar “Edukimi seksual si aftësi për jetën”, dhe një sërë modulesh po pilotohen në arsimin parauniversitar duke u integruar në këto lëndë mësimore: biologji, edukim fizik dhe shëndetësor, qytetari, edukim për karrierë dhe aftësim për jetën. Ministria e Arsimit dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit janë përgjegjës kryesorë për zhvillimin e kurrikulës, por bashkëpunëtorë të tjerë si organizatat joqeveritare, mësuesit, profesionistët e edukimit, profesionistët e shëndetit dhe të rinjtë janë përfshirë gjithashtu në konsultime dhe rishikimin e kurrikulës. Udhëzues ndërkombëtarë përfshirë *Standartet për edukimin seksual në Europë*, janë përdorur gjerësisht për zhvillimin e kurrikulës. Kjo kurrikulë mbulon në detaje një gamë të gjerë çështjesh, përfshirë shtatzëninë, kontracepsionin, HIV, rolet gjinore, median online dhe seksualitetin, dashurinë dhe martesën. Materialet mësimore dhe udhëzuesit reflektojnë një përqaasje të të mësuarit me pjesëmarrje.